

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"E – My shop" SHPK

EMËRTIMI - SELIA - KOHËZGJATJA

NENI 1.

KRIJIMI, EMËRTIMI I SHOQËRISË.

1.1 Sot më datë 09.02.2021 në bazë të nenit nr.100 të Kushtetues së Republikës së Shqipërisë si dhe në bazë të ligjit nr,9901 datë 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare " të ndryshuar , krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "*E My Shop*" Shpk, në vijim e quajtur "Shoqëria".

1.2 Shoqëria themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar,e identifikuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 2.

SELIA

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën : - Rruga "Myslym Shyri" Pallati nr.6, Shkalla nr.4, Apartamenti nr. 25 ".

2.2 Me vendim të Asamblese së Ortakëve, shoqëria mund të hapë zyra përfaqesie, degë, dhe/ose të krijojë filiale brënda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3.

KOHËZGJATJA

3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar,në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi,duke filluar nga rregjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 4.

OBJEKTI I SHOQËRISË

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e aktivitetit ekonomik të lejuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare si më poshtë :

1-Marketing, telemarketing, shitje, import-eksport i artikujve ushqimor e industrial, si dhe cdo aktivitet te lejuar me ligj.

2-Mund te kryej cdo lloj veprimtarie tjeter qe eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe qe siguron fitime dhe te ardhura te ligjshme brenda kufijve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, si dhe mund te kryeje cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e saj.

KAPITALI

PASURIA DHE FINANCIMI I SHOQERISE

NENI 5.

KAPITALI THEMELTAR.

5.1 Kapitali themeltar është 1,000 (Nje mije) lekë ose ekuivalenti i kësaj shume në monedhën euro (konvertuar me kursin aktual të këmbimit) , i ndarë në 2 (Dy) kuota të zakonshme me vlerë nominale 500 (pesë qind) lekë për një kuotë. Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 6.

ORTAKËT.

6.1 Kapitali i shoqërise përbëhet nga kontributi në para dhe zotërohet nga dy ortake me kuota te barabarta nga 50%:

1- **Z. Elijor Alibali**, shtetas shqiptar ,i biri i Zyhdi , lindur më datë 24.08.1981, në Tirane dhe banues në Tiranë , Rruga "Kongresi i Lushnjes" i identifikuar me leternjoftimin me nr.035716880 dhe me numer personal I10824131B , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

2- **Z. Edison Xhetani**, shtetas shqiptar ,i biri i Mexhit , lindur më datë 06.11.1979, në Tirane dhe banues në Tiranë , Rruga "Myslym Shyri" i identifikuar me leternjoftimin me nr. 034323634 dhe me numer personal H91106042D , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

NENI 7.

TRANSFERIMI I KUOTAVE.

7.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme dhe pa miratimin paraprak të asamblesë së ortakëve.

7.2 Transferimi i kuotave duhet të realizohet në përputhje me ligjin dhe te regjistrohet ne QKB sipas parashikimeve ligjore.

NENI 8.

FINANCIMI I SHOQËRISË.

8.1. Shoqëria me qëllim arritjen e objektivit të saj, do të kërkoje financimin nëpërmjet mënyrave te parashikuara ne ligj, si : - financim nga ortakët , kredi bankare, hua dhe çdo forme tjetër ligjore financimi.

NENI 9.

ORGANET E SHOQËRISË.

9.1 Organet e Shoqërise janë:

- Administratori
- Asambleja e ortakeve

Vendimarrja dhe administrimi i Shoqërise është strukturuar me një nivel , në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 10.

ADMINISTRATORI

FUNKSIONET DHE KOMPETENCAT.

10.1 Shoqëria administrohet nga 2 (dy) Administrator. Administratori është i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet tregtare të shoqërise pa kufizim kompetencash, përveç atyre që ligji, akti i themelimit dhe statuti ja ngarkon Asamblesë së Ortakëve.

10.2 Administratori i shoqërise kryen administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë. Shoqëria ka si administrator të saj Zj. *Elisabeta Turani* shtetas shqiptar, e bija e Hasan, lindur më datë 31.10.1994, në Lubonje, Korçë dhe banues në Tiranë, rruga "Siri Kodra" e identifikuar me letërnjoftimin në nr. 032406531 dhe numër personal J46031049E, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Shoqëria ka si administrator të saj Zj. *Erta Xhetani* shtetas shqiptar, e bija e Lime, lindur më datë 25.03.1989, në Berat dhe banues në Tiranë, rruga "Myslym Shyri" e identifikuar me letërnjoftimin në nr. 032743036 dhe numër personal I95325073E, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

10.3 Administratori ka të gjitha kompetencat për të përfaqësuar shoqërinë në marrëdhënie me të tretët. Ai vepron në emër të shoqërisë dhe nënshkruan çdo dokument të shoqërisë. Administratori nuk ushtron kompetencat që ligji ose aktet e shoqërise ja japin shprehimisht Asamblese së Ortakëve. Administratori emërohet për një afat 5 (Pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje duke filluar nga data 09.02.2021 deri më datë 09.02.2026.

10.4 Administratori mund të autorizoj një person të tretë të kryejë veprime në QKB si : depozitim aktesh, vendimesh, bilance, statutin dhe çdo akt tjetër.

10.5. Administratori përfiton shpërblim/pagesa për punën e kryer në masën e përcaktuar me vendim të asamblese së ortakëve.

NENI 11.

ASAMBLEJA E ORTAKËVE

11.1. Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë i shoqërisë dhe vendos për çdo çështje që ligji ose ky statut ia rezervon asaj. Vendimet e Asamblesë janë të detyrueshme të zbatohen nga organet e shoqërisë.

11.2. Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve organizohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

11.3. Asambleja zhvillohet në mënyrë të rregullt dhe vendos në mënyrë të rregullt sipas kuorumit të parashikuar nga ligji.

11.4. Mbledhjet e Asamblese zhvillohen normalisht në seline e shoqërisë por, me vendim të saj Asambleja mund të mbledhet edhe në një vend tjetër brenda ose jashtë Shqipërisë.

11.5. Ortaket njoftohen për mbledhje në asamblese të pakten 7 (shtatë) ditë përpara dhe duhet të marrin njoftimin për datën, orën, vendin, rendin e ditës dhe të marrin kopjen e dokumenteve që lidhen me rendin e ditës.

11.6. Mbledhjet e Asamblese së Ortakëve mund të thirren nga Administratori / administratore, ose nga subjektet e parashikuara në ligj.

NENI 12.

VITI FINANCIAR.

12.1. Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

12.2. Bilanci i shoqërisë mbahet në përputhje me ligjin, miratimi dhe çdo veprim tjetër merret në përputhje me parashikimet ligjore.

NENI 13.

PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË.

13.1. Procedura e likuidimit të parashikuar në ligjin nr. 9901, datë 22.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" zbatohet në rastin e prishjes së shoqërisë.

13.2. Shoqëria priset në rastet e mëposhteme : me vendim te asamblese; me hapjen e procedurave te falimentimit; me vendim gjykate; dhe per cdo arsye tjeter parashikuar ne aktet e shoqerise ose ne legjislacionin shqiptar.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

NENI 14.

LIGJI I ZBATUESHËM.

14.1. Shoqëria do të kryejë veprimtarin e saj në përputhje me këtë akt themelimi dhe statut si dhe me parashikimet e ligjeve shqiptare. Për sa nuk është parashikuar në këtë dokument do të zbatohet ligji shqiptar nr.9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, i ndryshuar.

14.2. Ky akt themelimi dhe statut hartohet dhe nënshkruhet ne 3 kopje origjinale në gjuhen shqipe sot më dt. 09.02.2021 ,në Tiranë.


14.3 Ngarkohet Administratori i shoqërisë që të ndërmarrë të gjitha hapat dhe të kryejë të gjitha veprimet për rregjistrimin e këtij akti themelimi dhe të statutit të shoqërisë sipas parashimeve ligjore në fuqi.

Shoqëria "E My Shop " Shpk

ORTAKU I SHOQËRISË

EDISON XHETANI

EDISON XHETANI



ELIOR ALIBALI

ELIOR ALIBALI



Specimen Firme Administrator E My Shop

ELISABETA

Emer

TURANI

Mbiemer



Firme

ERTA

Emer

XHETANI

Mbiemer



Firme